



01 Nr. 696/24 Dt. 08.11.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e mjeteve

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ramadan Tarashaj -drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për pjesëmarrje në “Panairin Philoxenia Selanik 2024”, që do të mbahet nga data 14 nëntor 2024 deri më 16 nëntor 2024 në Selanik të Republikës së Greqisë, kështu që, për këtë qëllim, lejohet udhëtimi zyrtar, për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, ushqimit (mëngjesit dhe darkës, etj.), lejohen mjetet financiare në emër të Kompanisë CEO Shpk-Congress and Event Organization në shumën prej 730 € (shtatëqind e tridhjetë euro), si dhe lejohen mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurin.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

